



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2026
ME ZGJEDHJE - SESIONI I

SKEMË VLERËSIMI

Qytetari dhe Psikologji

Varianti B

23 qershor 2026

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Alternativa e saktë	B	B	C	A	D	B	A	B	A	B
Pyetja	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26
Alternativa e saktë	D	D	D	C	B	D	C	D	B	C

Vlerësimi është 1 pikë për çdo përgjigje të saktë

Përgjigjet e sakta për pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikë, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Qytetari

Pyetja 11 3 pikë

Model përgjigjeje

- 1) Analfabetizmi. Paaftësia e fëmijëve mbi 6 vjeç për të lexuar dhe shkruar në një gjuhë të caktuar, duke kufizuar pjesëmarrjen e individit në arsim dhe në jetën shoqërore.
- 2) Analfabetizmi funksional. Mos kryerja e të gjitha aktiviteteve që lidhen me njohuritë e përgjithshme. Nxënësit nuk arrijnë të përdorin në mënyrë efektive shkrimin, leximin dhe njohuritë bazë në situata reale të jetës.
- 3) Mungesa e gjithëpërfshirjes dhe ofrimit të mundësive të barabarta. Mos përfshirja e gjithë nxënësve në mënyrë të barabartë, për shkak të dallimeve, gjinisë, racës, prejardhjes, statusit social etj.

- 4) Mospërshtatja e programeve mësimore me kërkesat e tregut të punës. Tregu i punës ndryshon me shpejtësi të madhe dhe është e domosdoshme që nxënësit të fitojnë aftësi praktike dhe kompetenca të nevojshme për punësim.
- 5) Shfaqja e sjelljeve devijuese dhe konflikteve në shkollë. Administrimi i tyre përbën një sfidë, pasi kërkon krijimin e një mjedisi të sigurt. Përdorimi i dhunës në shkollë përbën një problem serioz që ndikon negativisht në sigurinë, klimën shkollore dhe procesin e të nxënësve.
Etj.

Nxënësi fiton:

- 4 pikë** nëse shpjegon katër nga problemet;
3 pikë nëse shpjegon tri nga problemet;
2 pikë nëse shpjegon dy nga problemet;
1 pikë nëse shpjegon një nga problemet;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 3 pikë**Model përgjigjeje**

- 1) Informacioni mund të jetë i pasaktë ose i vjetëruar (i papërditësuar).
- 2) Mund të ketë informacion të njëanshëm ose përzgjedhje të gabuar që nuk pasqyron të gjitha faktet.
- 3) Përdorimi i informacionit pa referenca mund të çojë në plagjiaturë.
- 4) Burimet mund të mos jenë të sigurta (informacione nga blogje personale) dhe mund të çojnë në keqinformim.
- 5) Burimet mund të jenë të paplota ose nuk japin të gjitha të dhënat e nevojshme.
- 6) Informacioni mund të ndryshojë shpejt, prandaj mund të mos jetë i qëndrueshëm.
- 7) Disa burime mund të jenë me paragjykime ose të influencuara nga interesa komerciale/politike.
Etj.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** nëse shpjegon tri kufizime;
2 pikë nëse shpjegon dy kufizime;
1 pikë nëse shpjegon një kufizim;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 3 pikë**Model përgjigjeje**

- 1) Legjislacioni i punës është i rëndësishëm, sepse e mbron nga puna shtesë pa pagesë. Sipas ligjit, lliri duhet të paguhet për çdo orë shtesë që punon.
Ligji vendos kufij të qartë për orët maksimale të punës. Pa këtë kuadër ligjor, punëdhënësit mund të abuzojnë, duke i kërkuar të punojnë me orë të zgjatura pa pushimin e nevojshëm, gjë që dëmton mirëqenien e tij.
- 2) Legjislacioni i punës garanton që lliri të ketë kushte të sigurta pune, si dhe pajisje mbrojtëse.
Legjislacioni i punës detyron punëdhënësin të sigurojë mjete mbrojtëse, duke parandaluar aksidentet dhe sëmundjet profesionale që kërcënojnë jetën e punonjësve.
- 3) Legjislacioni i punës mbron llirin nga abuzimi i punëdhënësit dhe siguron që punëdhënësi të respektojë rregullat dhe kontratën e punës.
Legjislacioni garanton që çdo kontribut apo punë shtesë të paguhet sipas normave ligjore, duke parandaluar abuzimin financiar me punëmarrësit.
- 4) Legjislacioni i punës ndihmon llirin të kërkojë të drejtat në mënyrë ligjore.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** nëse jep tri argumente;
2 pikë nëse jep dy argumente;
1 pikë nëse jep një argument;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14 3 pikë**Model përgjigjeje**

- Liria e shprehjes, e medias, informimi i publikut me të drejtën për jetë private (privatësi), mbrojtjen e imazhit personal.
- Argumenti pro: Dëgjesa publike është një ngjarje me interes të përgjithshëm publik, ndaj informimi përmes publikimit të imazheve është i drejtë pasi ajo zhvillohet në një ambient publik. Gazetari ka detyrën profesionale të informojë shoqërinë dhe në raste të tilla, interesi i publikut për t'u informuar ka më shumë rëndësi kundrejt kërkesës individuale për privatësi.
- Argumenti kundër: Media duhet të respektojë kufijtë e privatësisë duke shmangur publikimin e imazheve që dëmtojnë padrejtësisht individin.
Çdo individ ka të drejtën e kontrollit mbi imazhin e tij. Pjesëmarrja në një aktivitet nuk do të thotë automatikisht heqje dorë nga privatësia, sidomos nëse publikimi i fotos mund të ketë pasoja negative për individin në jetën e tij private apo profesionale.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** nëse identifikon të drejtat në konflikt dhe mban një qëndrim pro dhe një qëndrim kundër.
2 pikë nëse identifikon të drejtat në konflikt dhe mban një qëndrim pro OSE një qëndrim kundër; nëse mban një qëndrim pro dhe një qëndrim kundër;
1 pikë nëse identifikon të drejtat në konflikt; nëse mban një qëndrim pro OSE një qëndrim kundër.
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15 4 pikë**Model përgjigjeje**

- 1) Ndikim në rezultatet shkollore – duke qenë se është fëmijë dhe punon, ka më pak kohë dhe energji për shkollë, gjë që ul përqendrimin dhe rezultatet e tij.
- 2) Ndikim negativ në mirëqenien emocionale – puna e tepërt shkakton lodhje, stres dhe ndikon negativisht në gjendjen emocionale të fëmijës.
- 3) Kufizim i zhvillimit social – mungesa e kohës për lojëra dhe shoqëri pengon ndërveprimin bashkëmoshatar për zhvillimin e aftësive sociale.
- 4) Kufizim i mundësive për të ardhmen – puna në moshë të vogël ndikon në rezultatet në shkollë dhe e bën më të vështirë zhvillimin e aftësive për të ardhmen.
- 5) Ndikim negativ në rritjen dhe zhvillimin fizik. Puna fizike që lidhet kryesisht me ngritjen e peshave të rënda ose ekspozimi ndaj lëndëve të dëmshme ndikon në shëndetin fizik.
Etj.

Nxënësi fiton:

- 4 pikë** nëse përshkruan katër pasoja të punës te fëmijët;
3 pikë nëse përshkruan tri pasoja të punës te fëmijët;
2 pikë nëse përshkruan dy pasoja të punës te fëmijët;

1 pikë nëse përshkruan një pasojë të punës te fëmijët;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 3 pikë

Model përgjigjeje

- Faktori kulturor; Faktori shoqëror;
- Të drejta:
 - 1) E drejta për të zgjedhur midis alternativave;
 - 2) E drejta për të qenë i/e informuar, të dijë më shumë rreth produktit që blen;
 - 3) E drejta për zëvendësim të një produkti të dëmtuar në shitje etj.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse identifikon faktorin dhe shpjegon dy të drejta të konsumatorëve;

2 pikë nëse identifikon faktorin dhe shpjegon një të drejtë të konsumatorëve; nëse shpjegon dy të drejta të konsumatorëve;

1 pikë nëse identifikon faktorin; nëse shpjegon një të drejtë të konsumatorëve;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Psikologji

Pyetja 27 3 pikë

Model përgjigjeje

- Teoria humaniste; Motivacioni si përpjekje drejt vetaktualizimit.
- 1) Përbushja e nevojave bazë si parakusht për rritje në hierarki nga poshtë-lartë.
Artistët u mbështetën financiarisht për të siguruar nevojat bazë për jetën.
Individi nuk mund të kalojë nivele të larta zhvillimi pa plotësuar nevojat që janë në bazë të piramidës.
- 2) Nevojat janë hierarkike, nevoja për vlerësim.
U vlerësuan nga shoqëria për punën e tyre.
- 3) Zhvillimi i potencialit, vetaktualizimi, ku shfaqet krijimtaria dhe talenti.
Artistët zhvilluan aftësitë dhe shprehën potencialin e tyre krijues.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse përcakton teorinë dhe përshkruan dy karakteristika të saj ilustruar me elemente nga rasti;

2 pikë nëse përcakton teorinë dhe përshkruan një karakteristikë të saj ilustruar me element nga rasti; nëse përshkruan dy karakteristika të teorisë, të ilustruara me elemente nga rasti;

1 pikë nëse përcakton teorinë; nëse përshkruan një karakteristikë të teorisë, ilustruar me element nga rasti;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28 3 pikë

Model përgjigjeje

- Drejtimit biheviorist
- 1) Për drejtimin biheviorist sjellja e njeriut përcaktohet nga kërkesa e mjedisit ku ai jeton e ndërvepron.
- 2) Psikologjia e drejtimit biheviorist studion vetëm sjelljet e jashtme, ato sjellje që mund të vëzhgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

- 3) Drejtimi bihejviorist studion sjelljet e dukshme të cilat mund të maten objektivisht.
- 4) Proceset mendore nuk duhet të jenë objekt i studimit të psikologjisë, sepse janë veprimtari të brendshme dhe nuk mund të vëzhgohen e maten në mënyrë shkencore.
Etj.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** nëse përcakton drejtimin dhe përshkruan dy karakteristika;
2 pikë nëse përcakton drejtimin dhe përshkruan një karakteristike;
1 pikë nëse përcakton drejtimin; nëse përshkruan një karakteristike;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Kognitiv: njerëzit me inteligjencë të lartë emocionale zotërojnë aftësi për të perceptuar, kuptuar, njohur, emocionet e tyre dhe të të tjerëve. Ata kuptojnë ndjenjat e tyre ose të të tjerëve, duke reaguar në mënyrë të përshtatshme, racionale.
Interpretojnë emocionet e tyre dhe të të tjerëve, vlerësojnë situatat në mënyrë racionale përpara se të veprojnë.
- Fiziologjik: njerëzit me inteligjencë të lartë emocionale menaxhojnë përgjigjet e tyre fiziologjike nga emocionet, si rrahjet e forta të zemrës, ankthin etj., përmes vetërregullimit, praktikës së frymëmarrjes së thellë për t'u qetësuar etj.
Ata arrijnë të kontrollojnë reagimet trupore si rrahjet e zemrës, tensioni apo ankthi, duke ruajtur qetësinë dhe duke mos lejuar që emocionet t'i dominojnë në situata stresuese.

Nxënësi fiton:

- 2 pikë** nëse vlerëson dy karakteristika;
1 pikë nëse vlerëson një karakteristike;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30 3 pikë**Model përgjigjeje**

- Kodimi, kolaudimi është procesi i futjes së informacionit në kujtesë, në mënyrë që të përdoret.
Sistemi nervor krijon një përfaqësim mendor të stimujve që perceptohen.
Kujtesa njerëzore përdor tri lloje kodesh: kodet dëgjimore (informacion në formë tingujsh), kodet pamore (informacion në formën e pamjeve, imazheve), kodet semantike (informacion në bazë të kuptimit të tij).
- Depozitimi është procesi i gjetjes dhe i ruajtjes së informacionit në kujtesë. Përmes këtij procesi informacioni mbahet në kujtesë për periudha të caktuara.
Kujtesa semantike, episodike dhe procedurale depozitohen për një kohë të gjatë.
- Riprodhimi është procesi i gjetjes dhe i nxjerrjes së informacionit nga sistemi i kujtesës, me qëllim që të përdoret kur nevojitet.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** nëse përshkruan tri proceset e kujtesës;
2 pikë nëse përshkruan dy proceset e kujtesës;
1 pikë nëse përshkruan një proces të kujtesës;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 3 pikë**Model përgjigjeje**

- Komplanca – Ndryshim i sjelljes sipas kërkesës së dikujt.
Shumë zyrtarë që nuk pajtoheshin me këto masa, pranojnë kërkesat e drejtpërdrejta të eprorëve.
Shumë zyrtarë u përgjigjen kërkesave të drejtpërdrejta të eprorëve, për të ruajtur vendin e punës, ndonëse privatisht nuk janë dakord.
- Obedienca – bindja dhe zbatimi i urdhrave të autoriteteve.
Imponimi i urdhrave dhe zbatimi i rreptë i tyre.
Urdhrat u zbatuan rreptësisht.
- Konformizmi – Individët ndryshojnë sjelljen ose qëndrimet e tyre, pa kërkesë të drejtpërdrejtë, thjesht për t'u përshtatur me sjelljen e shumicës, për t'u pranuar.
Një pjesë e shoqërisë përshtat sjelljen e saj në publik për t'u pranuar dhe për të qenë të ngjashëm me të tjerët.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** nëse analizon tri forma të ndikimit social;
2 pikë nëse analizon dy forma të ndikimit social;
1 pikë nëse analizon një formë të ndikimit social;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 2 pikë**Model përgjigjeje**

- 1) Menaxhimi i kohës dhe pushimi i rregullt – organizimi i detyrave dhe marrja e pushimeve ndihmon në uljen e stresit dhe shmangien e mbingarkesës mendore.
- 2) Aktiviteti fizik dhe teknikat e relaksimit – ushtrimet fizike, ecja, sporti ose teknikat e relaksimit (si frymëmarrja e thellë, relaksimi progresiv i muskujve) ndihmojnë në uljen e ankthit dhe përmirësimin e gjendjes emocionale.
- 3) Shmangia e mbingarkesës dhe vendosja e prioriteteve – ndihmon në uljen e presionit dhe organizimin më të mirë të detyrave.
- 4) Angazhimi në aktivitete relaksuese – si leximi, muzika, meditimi (teknika për qendruese), hobi ose aktivitetet kreative që ndihmojnë në qetësimin mendor.
- 5) Kërkimi i ndihmës profesionale kur është e nevojshme – psikologu ose këshillimi profesional ndihmon në menaxhimin e stresit dhe emocioneve.
Etj.

Nxënësi fiton:

- 2 pikë** nëse analizon dy mënyra;
1 pikë nëse analizon një mënyrë;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33 4 pikë**Model përgjigjeje**

- Intervista – jep mundësi që të merret informacion i detajuar mbi sjelljen dhe qëndrimet e nxënësve, përmes pyetjeve të llojeve të ndryshme.
- Vëzhgimi – studiohet sjellja e dukshme e nxënësve dhe veçanërisht kur nuk e di që po studiohet.
- Testet objektive – instrument i standardizuar përmes së cilës nxënësit shprehin nëse disa formulime janë të vërteta ose të pavërteta për ta.

- Testet projektive – instrumente me anë të të cilave merren informacione për personalitetin përmes asaj që nxënësi projektton për një figurë të paqartë.

Nxënësi fiton:

4 pikë nëse shpjegon katër teknika;

3 pikë nëse shpjegon tri teknika;

2 pikë nëse shpjegon dy teknika;

1 pikë nëse shpjegon një teknikë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
